


## KONTRATE SHITJE

Sot ne Tirane me date 25.11.2005, ndermjet paleve;

**SHITES:** Shoqeria "EDIZIONI PANORAMA" S.r.l., person juridik italian i regjistruar ne Itali, me numer rregjistrimi IVA no. 04135820480, Marco Giolli, ne baze te prokures se posaçme date 25 Tetor 2005, rep. 47.610, perpiluar nga Noteri Italian Francesco Di Mario.

**BLERES:** Dario BERTI, shtetas Italian, shtetas Italian, lindur me 10.11.1969, me numer pasaporte nr.208196P, banues ne Firenze – Itali.



### MEQENESE

1. Shitesi, Shoqeria "EDIZIONI PANORAMA" S.r.l., zoteron 25(njzetepese)pjeseve te kapitalit te Shoqerise "ÇELESI" Sh.p.k, person juridik shqiptar i regjistruar me vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane nr.18233, date 04.12.1997.
2. Shoqeria "EDIZIONI PANORAMA" S.r.l., me Vendimin e Asamblese se Ortakeve date date 14.10.2005 , ka vendosur te shese 12.5 pjeset qe zoteron ne kapitalin e Shoqerise "ÇELESI" Sh.p.k., bleresit, Dario Berti.
3. Shitesi garanton Bleresin se ne daten e sotme, pronesia e tij mbi pjeset eshte e lire nga çdo barre, peng dhe çdo lloj detyrimi tjeter ligjor.

### PALET BIEN DAKORT PERSA ME POSHTE VIJON

2. Shitesi, Shoqeria "EDIZIONI PANORAMA" S.r.l., i shet Bleresit Dario Berti, 12.5(dymbjedhjepikepese) pjese qe zoteron ne kapitalin e Shoqerise "ÇELESI" Sh.p.k, perkundrejt çmimit 12.500leke(dymbledhjetmijepeseqind).
- 2.1 Bleresi Dario Berti, i pagoi Shitesit, Shoqeria "EDIZIONI PANORAMA" S.r.l., te gjithë shumen e çmimit te shitjes prej 12.500leke(dymbledhjetmijepeseqind).
3. Ne momentin e nenshkrimit te kesaj kontrate Bleresi Dario Berti, fiton pronesine mbi 12.5 pjeset qe Shitesi, shoqeria "EDIZIONI PANORAMA" S.r.l., zoteronte ne kapitalin e Shoqerise "ÇELESI" Sh.p.k, te cilat perbejne 12.5% te kapitalit te kesaj te fundit, duke u bere Ortak i Shoqerise "ÇELESI" Sh.p.k, me 12.5 pjese.


- 3.1 Shitesi "EDIZIONI PANORAMA" S.r.l., nga ky moment, humb ne menyre te plote dhe definitive pronesine mbi 12.5 pjeset qe shet dhe mbi çdo te drejte tjeter qe i rridhte prej tyre.
4. Shitesi dhe Bleresi autorizojne qe kjo kontrate te depozitohet ne Zyren e Regjistrimit Tregtar prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Kjo kontrate hartohet ne 5 kopje me vlere te njejte, tre ne gjuhen shqipe dhe dy ne ate italiane.

PALET

SHITES

Shoqeria "EDIZIONI PANORAMA" S.r.l.  
Perfaqesuar nga  
Marco Giolli



Handwritten signature of Marco Giolli, consisting of a large, stylized cursive script.

BLERES

Dario Berti



Handwritten signature of Dario Berti, consisting of a stylized cursive script.